

**RELACION
PËR
PROJEKTVENDIMIN**

**"PËR MIRATIMIN E VLERAVE PËR SECILIN ELEMENT PËRBËRËS
TË PAGËS BRUTO MUJORE TË PUNONJËSVE TË SHËRBIMIT TË
MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPËTIMIN"**

**I. QËLLIMI I PROJEKTVENDIMIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN
TË ARRIHEN**

Ky projektvendim ka si qëllim rritjen e pagave të punonjësve të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, në vijim të reformës dhe rritjes së pagave të nëpunësve/punonjësve të administratës publike të ndërmarrë nga Qeveria Shqiptare, në plan afatmesëm.

**II. VLERËSIMI I PROJEKTVENDIMIT NË RAPORT ME PROGRAMIN
POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN
ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE**

Projektvëndimi hartohet si pasojë e detyrimit ligjor që ka Këshilli i Ministrave për të bërë përcaktimë/rregullime/ndryshime në vendimet e pagave për institucionet e administratës shtetërore, qendrore apo vendore, sa herë që është e nevojshme.

**III. ARGUMENTIMI I PROJEKTVENDIMIT LIDHUR ME
PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME**

Në vijim të procesit për reformën e pagave të nëpunësve/punonjësve të administratës publike dhe rritjen e niveleve të tyre, të parashikuar për vitet 2023 – 2024, bazuar në iniciativën e qeverisë shqiptare për këtë qëllim, për punonjësit e Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, në këtë projektvendim parashikohen nivelet e rritjes së pagës për gradë, për vitin 2024.

Bazuar nē sa mē sipēr, eshtē pērgatitur ky projektvendim nēpērmjet tē cilit realizohet njē rritje e vlerave tē pagave sipas gradave, pēr punonjēsit e kētij shērbimi. Rritja e pagave sipas gradave nē pērqindje varion nga 6.5% deri nē 30.4%, ose nē lekē pēr punonjēsit e niveliit bazē dhe tē niveli tē mesēm, pēr gradat nga "Asistent Zjarrfikēs" deri nē "Kryeinspektor Zjarrfikēs", nga 10,500 lekē nē muaj deri nē 14,000 lekē nē muaj, ndērsa pēr punonjēsit e niveliit tē mesēm, pēr gradēn "Komisar Zjarrfikēs" deri nē nivelin madhor pēr gradēn "Drejtues i Lartē Zjarrfikēs", nga 7,500 lekē nē muaj deri nē 28,500 lekē nē muaj.

Ndryshimi i pagave bazē pēr gradē paraqitet nē tabelēn si vijon:

Grada	Paga aktuale mujore pēr gradē	Rritja nē pērqindje	Rritja nē vlerē	Paga e re mujore pēr gradē
Asistent Zjarrfikēs	46,000	30.43	14,000	60,000
Zjarrfikēs	52,500	23.81	12,500	65,000
Kryezjarrfikēs	55,000	27.27	15,000	70,000
Inspektor Zjarrfikēs	64,200	16.82	10,800	75,000
Kryeinspektor Zjarrfikēs	74,500	14.09	10,500	85,000
Komisar Zjarrfikēs	97,500	7.69	7,500	105,000
Drejtues Zjarrfikēs	108,000	6.48	7,000	115,000
Drejtues i Parē Zjarrfikēs	120,000	16.67	20,000	140,000
Drejtues i Lartē Zjarrfikēs	131,500	21.67	28,500	160,000

Nga miratimi i kētij projektvendimi pērfitojnē rreth 1200 punonjēs tē Shērbimit tē Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpētimin, nē nivel qendoror dhe nē nivel vendor.

IV. VLERĒSIMI I LIGJSHMĒRISĒ, KUSHTETUTSHMĒRISĒ DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NĒ FUQI VENDAS E NDĒRKOMBĒTAR

Projektvendimi eshtē hartuar nē mbēshtetje tē:

- Nenit 100, tē Kushtetutēs sē Republikēs sē Shqipērisē;

Relacion pēr projektvendimin "Pēr miratimin e vlerave pēr secilin element pērbērēs tē pagēs bruto mujore tē punonjēsve tē Shērbimit tē Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpētimin".

- Ligjit nr. 35/2023, “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi”;
- Ligjit nr. 152/2015, “Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Projektvendimi nuk synon përafrimin me ndonjë *acquis* të BE-së.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTVENDIMIT

Projektvendimi hartohet si një vendim i ri, për shkak të miratimit të ligjit nr.35/2023, “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi” dhe propozohet nga Zëvendëskryeministri.

Projektvendimi ka 7 (shtatë) pika dhe një lidhje bashkëlidhur dhe propozon:

Pika e parë përcakton qëllimin e vendimit - miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave për punonjësit e Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin;

Pika e dytë (shkronjat “a”, “b”, “c”) përcakton elementet e pagës bruto mujore dhe vlerat e çdo elementi përbërës të saj, për punonjësit e Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin:

- a) Paga për gradë, vlerat e së cilës janë sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
- b) Shtesa mujore për natyrë të veçantë pune, që u jepet punonjësve të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, për natyrën e veçantë të punës e të shërbimit që kryejnë, vlera e së cilës për çdo funksion/pozicion që e përfiton këtë shtesë, përcaktohet në lidhjen nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
- c) Shtesa mujore mbi pagë për vjetërsi shërbimi, është shtesa që përfiton punonjësi i Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, për çdo vit vjetërsi në shërbim,

në masën 1 për qind për çdo vit, deri në 25 vjet. Kjo shtesë llogaritet mbi vlerën e pagës bazë të gradës "Asistent zjarrfikës".

Pika e tretë përcakton vitet e shërbimit, që konsiderohen vitet e qëndrimit në gradë, në strukturat e Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin dhe në struktura të tjera të ngjashme, e që do të merren parasysh përfektivitë llogaritjes së shtesës përvjetërsi përfektivitë punonjës, (vetëm përfektivitë page);

Pika e katërt: parashikon vitet që përjashtohen nga llogaritja e shtesës përvjetërsi shërbimi, (vetëm përfektivitë page);

Pika e pestë: përcakton përballimin e efekteve financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, që përvitin 2024, do të përballohen nga fondet e politikës përritjen e pagave të përcaktuara në ligjin 97/2023, "Për buxhetin e vitit 2024", të ndryshuar, në nivel qendror dhe në nivel vendor.

Pika e gjashtë: parashikon shfuqizimin e vendimit nr. 350, datë 19.04.2017, të Këshillit të Ministrave, "Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin", të ndryshuar;

Pika e shtatë: përcakton institucionet që ngarkohen përzbatimin e këtij vendimi që janë Ministria e Brendshme për SHMZSH në nivel qendror dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore në nivel vendor.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTVENDIMIT

Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Ministria e Brendshme dhe Shërbimi i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin në nivel qendror dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore në nivel vendor.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTVENDIMIT

Ky projektvendim është hartuar nga Departamenti i Administratës Publike dhe është konsultuar në fazën e përgatitjes së tij me Ministrinë e Financave.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETOKE

Relacion për projektvendimin "Për miratimin e vlerave për secilin element përbërës të pagës bruto mujore të punonjësve të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin".

Efekti finansiar i miratimit të këtij projektvendimi, sipas llogaritjeve të ministrisë së Financave është rreth 21,250,000 (njëzetë e një milionë e dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë në muaj, për paga dhe sigurime shoqërore e shëndetësore, efekt që do të përballohet nga fondi i kontigjencës përritjen e pagave, sipas përcaktimeve në ligjin 97/2023, "Për buxhetin e vitit 2024", të ndryshuar, në nivel qendror dhe në nivel vendor.

PROPOZUESI
ZËVENDËSKRYEMINISTRI
BELINDA BALLUKU

Relacion për projektvendimin "Për miratimin e vlerave për secilin element përbërës të pagës bruto mujore të punonjësve të Shërbimit të Mbrotjes nga Zjarri dhe Shpëtimin".